

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Gruaja i vrau tre fëmijët e tyre/ “Lëreni të paktën një të jetojë”, lutja e dëshpëruar e Patrick Clancy-t, falja për Lindsay-n dhe jeta pas tragjedisë
ADRESA	https://top-channel.tv/2026/09/21/gruaja-i-vrau-tre-femijet-e-tyre-lereni-te-pakten-nje-te-jetoje-lutja-e-deshperuar-e-patrick-clancy-t-falja-per-lindsay-n-dhe-jeta-pas-tragjedise/
BURIMI	top-channel.tv
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	21 shtator 2026, 06:00:00 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
LEXUAR NGA FAQJA	21 shtator 2026, 05:53:00 UTC <i>Portali nuk e deklaroi datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me meto dën text_date. Dritarja: 21 shtator 2026, 05:52:00 UTC → 21 shtator 2026, 05:54:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund t ë gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	2a5fc422f12487ebaed5d858c4d817f011c1fdb202ef8569bfeca72566ee666c
TEKSTI	677f9a1e6fc3b2e12b8f5eb8d49f18383c081143c93c73bf9d8e29c5e479c1e9
PAMJA	77ff289faaf9580bee1cbb44cbb6f04835a40c6640c6452770aa3a775817ead9

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	02226d5d6e48237fce82dabad7f50428cd595c29a7b996ef11401062130a0414
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	d754d95d3fb9effc97224ab6ddd249dd26dc09b477f9e15caf646cb8e3153b6a
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/02226d5d6e48237fce82dabad7f50428cd595c29a7b996ef11401062130a0414>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

BOTA KRYESORE TË FUNDIT

Gruaja i vrau tre fëmijët e tyre/ "Lëreni të paktën një të jetojë", lutja e dëshpëruar e Patrick Clancy-t, falja për Lindsay-n dhe jeta pas tragjedisë

21/09/2026 07:53



Më shumë se tre vjet pas tragjedisë që i mori jetën tre fëmijëve të tij, Patrick Clancy ka rrëfyer për "60 Minutes" të CBS-it momentet më të dhimbshme të asaj nate, përballjen me humbjen dhe vendimin e tij për të falur ish-gruan, Lindsay Clancy, e cila akuzohet për vrasjen e tre fëmijëve të tyre në Massachusetts, në janar 2023.

Në intervistën e tij, Clancy foli për orët e fundit që kaloi me fëmijët, përpjekjen dëshpëruese për të shpëtuar të paktën foshnjën Callan dhe mënyrën se si ka tentuar të rindërtojë jetën pas humbjes së tre fëmijëve.

Ngjarja ndodhi më 24 janar 2023, në shtëpinë e familjes në Duxbury. Patrick ishte larguar për pak kohë nga banesa për të kryer një punë dhe kur u kthye gjeti tre fëmijët në bodrum, ndërsa Lindsay ishte e plagosur në oborr pas një tentative për vetëvrasje.

Cora dhe Dawson nuk mundën të mbijetonin. Ndërsa Callan, vetëm tetë muajsh, u gjet ende gjallë dhe u transportua me helikopter në spital. Ai jetoi edhe katër ditë, ndërsa babai qëndroi pranë tij deri në momentet e fundit.

"Unë vërtet besoja se kishte një shans që Callan të jetonte", rrëfeu Clancy. Në dëshpërim, ai kujtoi se mendimi i vetëm që i kalonte në mendje ishte: "Më lini vetëm një, vetëm një fëmijë."

Ndërsa mbante Callan në një dorë, ai shkruante nekrologjitë për Cora dhe Dawson me dorën tjetër. Në fund, Callan vdiq në krahët e të atit.

Patrick Clancy ishte dëshmitari i parë në gjyqin e ish-gruas së tij dhe për dy ditë foli për përkeqësimin e gjendjes së saj pas lindjes së fëmijës së tretë.

Ai dëshmoi se Lindsay kishte qenë një nënë e përkushtuar dhe se i donte fëmijët e saj, por në muajt para tragjedisë kishte përjetuar stres të rëndë, ankth dhe probleme serioze të shëndetit mendor.

Sipas dëshmisë së tij, nga shtatori 2022 deri në janar 2023 ajo kishte marrë trajtime dhe medikamente të ndryshme, të përshkruara nga mjekë të ndryshëm.

Në një moment, Lindsay i kishte treguar bashkëshortit për mendimet e saj se diçka e keqe mund t'i ndodhte njërit prej fëmijëve. Megjithatë, Patrick tha se nuk besonte se ata ndodheshin në rrezik të menjëhershëm, pasi nuk kishte parë ndonjë qëllim të saj për t'i dëmtuar.

Kur u pyet nëse ndihej fajtor që nuk kishte mundur ta parandalonte tragjedinë, ai u përgjigj se kishte bërë "më të mirën që munda me atë që dinte në atë kohë".

Një prej pjesëve më të ndjeshme të intervistës ishte mënyra se si Patrick foli për Lindsay

I Kryesore



"Shqipëria nuk shitet"/ Protestat në Tiranë, Rama për gazetën gjermane: Zakonisht jam më i mirë kur ndihem i sfiduar

19:30

Manovrat me mishin nga Brazili/ Ministria bllokoi vetëm pulën dhe viçin, por lejohet derri. BE ka standard tjetër

19:40

Meloni paralajmëron masa të reja në shkollat në Itali: Kufizim për nxënësit e huaj dhe ndalim të burkave e hixhabeve

15:57

"Po të kthehesha pas, do të jetoja të njëjtën jetë"/ Kompozitori Gjergj Leka zbulon sekretin e rinisë: Më dënuan të punoja me 2700 vajza

19:15

Renditja/ Tre skuadra shpëputen në krye, Vllaznia prek fundin. Si paraqitet situata e Superiores pas javës së pestë

20:39

I Më të lexuarat

Meloni paralajmëron masa të reja në shkollat në Itali: Kufizim për nxënësit e huaj dhe ndalim të burkave e hixhabeve

Tronditëse në Greqi/ Theret për vdekje 25-vjeçarja. I dashuri pretendoi se u sulmuan, por nuk iu gjet asnjë plagë në trup

Ukraina sulmon për herë të parë Rusinë me raketën balistike 'Pelican', Zelensky: Goditëm objektet e industrisë së naftës

Trump përgatit sanksione të forta ndaj Gjykatës Ndërkombëtare Penale, WSJ: Mund të ndalohen transaksionet në dollarë

Foto/ U kap "mat" me Hamiltonin në hotel, modelja e njohur nuk përmbahet dhe i tregon të gjitha

Zgjedhjet në Gjermani/ Goditet CDU e Merz, AfD merr një tjetër fitore

Manovrat me mishin nga Brazili/ Ministria bllokoi vetëm pulën dhe viçin, por lejohet derri. BE ka standard tjetër

Ishte duke peshkuar në lumin Drini i Zi, 31-vjeçari bie në kontakt me rrymën elektrike dhe humb jetën

"Gjithçka është bërë e neveritshme"/ Real Madrid TV shpërthen pas humbjes ndaj Atléticos: La Liga s'ka asnjë më të

one vendimin e tij për ta ratur.

Ai tha se ish-gruaja e tij nuk i kishte kërkuar falje apo nuk i kishte kërkuar që ta falte. Megjithatë, për të, falja ishte bërë pjesë e procesit për të vazhduar jetën.

Pas vdekjes së fëmijëve, Clancy kaloi një periudhë në të cilën nuk dëshironte të jetonte dhe ndiente se nuk kishte më një qëllim. Ndihma nga specialistët e shëndetit mendor e ndihmoi gradualisht të përballej me humbjen.

Ai tha se kishte frikë se, nëse nuk arrinte ta falte Lindsay-n, zemërimi dhe dhimbja do ta konsumonin përgjithmonë.

Më shumë se tre vjet pas tragjedisë, Patrick thotë se ende u flet çdo ditë tre fëmijëve të tij.

Kur gazetari e pyeti se çfarë u thotë, ai dha një përgjigje të shkurtër: "Më ndihmoni."

Ai shpjegoi se dëshiron të besojë se fëmijët e tij ende e ndihmojnë në njëfarë mënyre dhe se ky komunikim është një mënyrë për të ruajtur lidhjen me ta.

Gjatë gjyqit u dëgjua edhe telefonata dramatike që Patrick i bëri shërbimeve të emergjencës natën e tragjedisë. Ai tregoi se, pak para se telefonata të dëgjohej në sallën e gjyqit, kishte përjetuar një sulm të fortë paniku.

Gjyqi ndaj Lindsay Clancy përfundoi më 4 shtator 2026, pasi juria nuk arriti një vendim unanim dhe gjykatësi shpalli një gjykim të pavlefshëm.

Mbrojtja e Lindsay argumentoi se ajo nuk ishte penalisht përgjegjëse për veprimet e saj për shkak të një gjendjeje të rëndë psikotike pas lindjes. Prokuroria, nga ana tjetër, argumentoi se ajo e dinte se çfarë po bënte dhe se vrasjet ishin të paramenduara.

Sipas juristëve që folën publikisht pas gjyqit, votimi përfundimtar ishte 11 me 1 në favor të shpalljes së saj të pafajshme për shkak të gjendjes mendore, por mungesa e unanimitetit bëri që gjykimi të përfundonte pa një verdikt.

Prokurori i Qarkut të Plymouth, Timothy Cruz, ende nuk ka njoftuar nëse do të kërkojë një gjyq të ri. Ndërkohë, avokatët e Lindsay kanë kërkuar që çështja të rrëzohet, duke iu referuar edhe argumenteve që lidhen me parimin e rrezikut të dyfishtë. Seanca e ardhshme është planifikuar për 29 shtator 2026.

Pas tragjedisë, Patrick u largua nga Massachusetts dhe u transferua në Nju Jork, duke shpresuar të jetonte larg vëmendjes publike.

Atje u njoh me Dr. Rachel Dennis, specialiste e mjekësisë riprodhuese. Të dy u takuan gjatë një vrapimi në Central Park dhe u martuan në prill të vitit 2026.

Dennis u shfaq edhe në intervistën e "60 Minutes", duke e përshkruar Patrick si një baba të përkushtuar dhe partner mbështetës.

Çifti tani po përpiqet të ndërtojë një jetë të re dhe të krijojë familjen e tyre. Megjithatë, për Patrick, Cora, Dawson dhe Callan mbeten pjesë e pandashme e saj.

Ai tha se, nëse do të ketë fëmijë të tjerë, dëshiron që një ditë t'u tregojë atyre për tre vëllezërit dhe motrën e tyre që humbën jetën në tragjedinë e vitit 2023.

Top Channel

I Bota »



Ngushtica e Hormuzit
boshatiset, vetëm 12 anije
kaluan gjatë fundjavës mes
tensioneve të larta dhe ngërçit
SHBA-Iran

21/09 07:42



Trump dhe Macron takohen sot
në Nju Jork, në fokus luftërat
dhe krizat ndërkombëtare

21/09 07:31



Ditë të vështira për kancelarin
Merz/ CDU pëson humbje
historike, AfD triumfon në
Mecklenburg, e Majta fiton
Berlinin

21/09 07:19





Tronditëse në Greqi/ Theret për vdekje 25-vjeçarja. I dashuri pretendoi se u sulmuan, por nuk iu gjet asnjë plagë në trup

20/09 22:55



Trump përgatit sanksione të forta ndaj Gjykatës Ndërkombëtare Penale, WSJ: Mund të ndalohen transaksionet në dollarë

20/09 22:30



Mbyllen zgjedhjet parlamentare në Rusi, Putin pritët të konsolidojë sërish pushtetin pas garës pa opozitën

20/09 21:09

I Kryesore »



Ngushtica e Hormuzit boshatiset, vetëm 12 anije kaluan gjatë fundjavës mes tensioneve të larta dhe ngërçit SHBA-Iran

21/09 07:42



Trump dhe Macron takohen sot në Nju Jork, në fokus luftërat dhe krizat ndërkombëtare

21/09 07:31




Ditë të vështira për kancelarin Merz/ CDU pëson humbje historike, AfD triumfon në Mecklenburg, e Majta fiton Berlinin

21/09 07:19



Java nis me shi, reshje në të gjithë territorin dhe shtrëngata të izoluar, parashikimi i motit për këtë të Hënë

21/09 07:08



Hasi mposht Besiktasin dhe "shpërthen" ndaj gjyqtarit, ja çfarë ndodhi pas ndeshjes

21/09 00:21



"Jo në emrin tim"/ Nata e pestë e protestës kundër vendimit të Hagës në Prishtinë, veterani Bekim Shyti: Liderët e UÇK-së janë dënuar padrejtësisht

20/09 22:51

Na ndiqni:



I Video »



Top Channel/ "Jo në emrin tim", nata e 5 e protestës në Prishtinë, veterani: U dënuar padrejtësisht



Top Channel/ Mbahet protesta e 113-të. Tiranë, qytetarët mbledhen përpara kryeministrit



Top Channel/ Protesta në ditën e 113-të, tubuesit: Të enjten sa më shumë para Kuvendit



Top Channel/ Ukraina goditi në ditën e zgjedhjeve, Rusia: Hakmarrje. Putin mban pushtetin



Top Channel/Rama për "Frankfurter Allgemeine Zeitung": Shqipëria nuk po shitet



Top Channel/ Tërmet politik në Gjermani. AfD merr deri në 38% të votave, Merz: Rezultat katastrofik

Lajme	Bota	Sport	Pop News	Programe	Top Channel
Lajmet e fundit	Opinion	Kombëtarja	Showbiz	Big Brother VIP	Rreth Top Channel
Politikë	Koment	Kategoria Superiore	Lifestyle	Për'puthen	Topin e kam unë – Aplikotani
Kronikë	Kosova dhe Rajoni	Kategoria e Parë	Fashion	Shqipëria LIVE	Kontakt
Aktualitet	Shkencë dhe Teknologji	Premier League	Shëndeti	Elks Fare	

Kërkime	Shënime dhe teknologji	Premier League	Shënime	Film dhe	Puno në Top Channel
Ekonomi	Auto	La Liga	Dieta	Video	Privacy Policy & Terms of Use
Sociale		Serie A	Receta gatimi	Të gjitha programet	Aksesueshmëria
Video		Shumësportësh		Guida TV	
Top News LIVE		Sport Gossip			
© Top Channel 2001 - 2026 • Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i përmbajtjes së kësaj faqeje.					

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.